



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:228131

Datë: 17.10.2024

Numri i dokumentit: 06314098

AC-I-23-0298

Në ankesën e

Paditësi

S S fshati G, Viti.

kundër

E paditura/ankuesja

N.SH "Morava e Binqës" (në likuidim), përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-13-2829 të datës 17 prill 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 17 tetor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së parë i DHPGJS-së, C-IV-13-2829 i datës 17 prill 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 05 nëntor 2013, paditësi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një padi/ankesë kundër Vendimit nr. GJI037-0025, të datës 16 tetor 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ka kërkuar kompensim për tre paga të papaguara dhe dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,500.00 €, nga NSH "Morava e Binçës". Paditësi pohoi se kërkesa e tij është e bazuar në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Punës, Statusin e NSH, Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/27 dhe Ligjin e Punës nr. 03L-212 të Republikës së Kosovës. Po ashtu paditësi pohoi se AL dhe NSH me refuzimin e kërkesës kanë bërë shkelje të rëndë të ligjeve të lartcekura, ngase të gjitha këto ligje e parashohin dhe precizojnë pagesën e pagave me prioritet në mënyrë lineare për tre muaj, nëse i ndërpritet marrëdhënia e punës pa fajin dhe dëshirën e tij. Po ashtu paditësi pohoi se Kolegjiumi profesional i NSH ka sjell vendimin nr. 760/3, ku nuk u diskriminua dhe nuk ku mohua asnjë e drejtë punëtorëve edhe pse u dërguan në pushim pa pagesë. Paditësi i propozoi gjykatës që e paditura t'i paguaj pagesat sipas vendimit GJI037-0025, të datës 16 tetor 2013, kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës dhe kompensimin për tri paga të pa paguara në vlerë prej 1,500.00€, me kamat deri në pagesën përfundimtare dhe ti kompensoj shpenzimet. Në mbështetje të ankesës si provë ka bashkangjitur dokumentet në kopje si: vendimin e kundërshtuar, letërnjoftimin, Përgjigjen e AKP-së të datës 07 mars 2011, aktvendimin mbi caktimin e vendit të punës së punëtorit dhe përcaktimin e bazës për llogaritjen e të ardhurave personale nr. 797 datë 15 maj 2000, aktvendimin mbi dërgimin e punëtorit në pushim me pagesë nr. 797 datë 27 dhjetor 2002, librezën e punës, vendimin mbi pushimin pa pagesë nr. 760/3 të datës 03 dhjetor 2003, padinë e datës 17 mars 2011.

Me 20 gusht 2014, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje, në të cilën pohoi se i AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se paditësi nuk ka saktësuar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit, dhe në këtë mënyrë ka shkelur Nenin 70.2 të Shtojcës së Ligjit 04/L033, i cili parasheh që ankesat e dorëzuara në DHPGJS, kundër vendimeve të AL-së, duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim

me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Më tej e paditura pohoi se nëse periodha për të cilën paditësi kërkon tri pagat e fundit të pa paguara ka qenë para gushtit, kërkesa është parashkruar për tri vjet nga koha kur punëdhënësi nuk ka përmbushur obligimin që rrjedh nga marrëdhënia e punës, ne bazë të nenit 36.2.1 të Ligjit nr. 04/L-034 dhe nenit 608 të Ligjit për Punë të Bashkuar (publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 53 të vitit 1976), e ky argument mbështetet me vendimet e lëshuara nga DHPGJS. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa pranueshme ose e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL-së në pajtim me nenin 70.4 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-033. E paditura në mbështetje të mbrojtjes dorëzoi: Vendimin për fillimin e likuidimit dhe emërimin e anëtarëve të AL, datë 3 qershor 2013 dhe Evidencën e punonjësve të përfshirë në listë të pagave të NSH-së.

Me 27 prill 2023, Shkalla e parë e DHPGJS-së, me Aktgjykimin C-IV-13-2829, ka aprovuar ankesën e paditësit si të bazuar, ka ndryshuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. GJI0037-0025, datë 16 tetor 2013 dhe ka obliguar të paditurën AKP, që paditësit, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, t'i paguaj shumën prej 750.00 € dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t'i paguaj shumën prej 75.00 €, të cilat shuma do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit. Po ashtu është obliguara e paditura AKP, që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në emër të pagesës së taksës gjyqësore në shumë prej 20.00 €.

Shkalla e parë ka konstatuar se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se paditësi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH "Morava e Binçës" në Gjilan. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se a ka qenë paditësi punëtor i NSH në momentin e privatizimit të saj dhe nëse NSH ka obligime ndaj paditësit si paga të papaguara apo çfarëdo obligimi në emër të kompensimit për shpërbërje të parakohshme. Paditësi pretendon se kërkesat e tij janë të bazuara në ligj dhe se e paditura ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës dhe se kjo dëshmohet nga librezat e punës, e cila iu është mbyllur me datë 09 maj 2008. E paditura i mbështet vendimin e kundërshtuar të AL dhe thekson se kërkesat e ankuesit për paga të papaguara dhe kompensim për ndërprerje janë të pasafatshme – janë parashkruar. E paditura nuk e ka kontestuar përvojën e punës dhe as lartësinë e kompensimit të pagave të kërkuara nga ankuesi.

Paditësi, bazën e kërkesës e mbështet në librezën e punës, Përgjigjen e AKP-së të datës 07 mars 2011 lidhur me kërkesën për kompensimin e pagave dhe të ardhurave tjera të datës 03 mars 2011, Padinë kolektive për pagesën e të ardhurave personale të datës 17 mars 2011, si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Shkalla e parë ka konstatuar se nga librezja e punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se paditësi kishte krijuar marrëdhënie pune me NSH "Morava e Binçës" prej datës 11 prill 1988 deri më 28 shkurt 1989, pastaj prej 06 mars 1989 deri më 27 dhjetor 1989 dhe përsëri prej 03 prill 2000 deri me 09 maj 2008, andaj i ka pranuar si prova relevante librezën e punës dhe dëshmitë tjera mbështetëse, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se paditësi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se paditësit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të tre pagave mujore në shumë prej 250.00 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme apo shumës totale prej 750.00 €, gjykata është bazuar në nenin 76.7.7.3 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe pagën që ka qenë në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, pagë të cilën e ka llogaritur vetë paditësi pranë AL dhe me rastin e parashtrimit të ankesës në DHPGJS. Tutje ka arsyetuar se një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e fundit të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit (AC-I-21-0041, AC-I-21-0039, etj.).

Gjithashtu ka aprovuar edhe shumën në lartësi prej 75.00 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Në lidhje me shumat e kërkuara përtej shumës së aprovuar siç janë: pagat tjera në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme dhe kërkesa për tri paga të papaguara në një shumë dhe periudhë të paspecifikuar kohore shkalla e parë ka vlerësuar se kërkesat në fjalë nuk janë të mbështetura në prova dhe si të tilla janë të pabazuara.

Më 19 maj 2023, e paditura AKP-ja ka pashtuar ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë C-IV-13-2829 të datës 27 prill 2023, për shkak të Vlerësimit të

gabuar të situatës faktike dhe vlerësimin të zbatimit të nenit 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit 04/L-034 dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e bashkuar nga Autoriteti i Likuidimit. E paditura në ankese ka propozuar që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar duke e refuzuar ankesën ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit si të pa bazuar dhe të vërtetohet Vendimi i AL. E paditura AKP-ja rithekson se parashtruesi nuk e saktëson se cili Nen i Ligjit 04/L034 është shkelur nga ana e Autoritetit të Likuidimit, duke shkelur nenin 70.2 i Shtojcës së Ligjit 04/L-033 i cili parashikon se Padia“ duhet te bazohet ne pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin 04/L034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ankuesja –AKP edhe me tutje pretendon se kërkesa e paditësit është parashkruara konform nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Tutje thekson se Shkalla e parë i ka ngatërruar aftët e që janë dy afate. Afati për paraqitjen e kërkesës kreditore dhe afati që ka të bëjë me parashkrimin e kërkesës e cila në fakt ka të bëjë me merita. Andaj bazuar në këto kërkesa e paditësit është parashkruara pasi që ai nuk e ka paraqitur kërkesën e tij brenda afatit 3 vjeçar në përputhje me nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuara.

Me 28 qershor 2024, Shkalla e dytë e DHPGJS, ka leshur Urdhër për paditësin që i njëjti të mund të parashtrorë përgjigje ndaj ankesës së AKP-së, i njëjti e ka pranuar urdhrin me dt. 08 korrik 2024, por nuk parashtruar asnjë përgjigje deri në marrjen e këtij Aktgjykimi.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa të paditurës është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar shkallës së parë i DHPGJS, C-IV-13-2829 i datës 17 prill 2023, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit e paraqitur me dt. 21 qershor 2013 tek AL për kompensimin për tre paga të pa paguara dhe kompensimin për ndërprerje

të parakohshme të marrëdhënies së punës në shumën prej 1,500.00 euro, por AL e kishte refuzuar si e pavlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Paditësi në ankesën e tij të paraqitur kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit, kishte bashkëngjitur këto prova: Vendimin e kundërshtuar, letërnjoftimin, Përgjigjen e AKP-së të datës 07 mars 2011, aktvendimin mbi caktimin e vendit të punës së punëtorit dhe përcaktimin e bazës për llogaritjen e të ardhurave personale nr. 797 datë 15 maj 2000, aktvendimin mbi dërgimin e punëtorit në pushim me pagesë nr. 797 datë 27 dhjetor 2002, librezën e punës, vendimin mbi pushimin pa pagesë nr. 760/3 të datës 03 dhjetor 2003, padinë e datës 17 mars 2011.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e parë e DHPGJS, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin ankesën e paditësit e kishte aprovuar si të bazuar, e kishte ndryshuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. GJI0037-0025, datës 16 tetor 2013, dhe kishte obliguar të paditurën AKP, që paditësit S S në emër kompensimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës ti paguajë shumën prej 750.00 euro dhe në emër të interesit ligjor prej 10% të shumës themelore, t'i paguajë shumën prej 75.00 euro, e te cilat shuma do te përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuara të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit. Po ashtu e kishte obliguar të paditurën AKP, që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në emër të pagesës së taksës gjyqësore në shumë prej 20.00 euro.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se Shkalla e parë e DHPGJS kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së Aktgjykimit, ndërsa konsideron se ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Kjo për faktin se nga provat që gjenden në shkresat e lëndës siç janë: librezat e punës dhe dëshmitë tjera mbështetëse si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, ishte vërtetuar se paditësi kishte qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit, pra deri me dt. 09 maj 2008 kur ishte ndërprerë edhe marrëdhënia e punës në NSH. E paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar se paditësit ia kishte ndërprerë

marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të shumës prej 750 euro, Shkalla e parë me të drejtë është bazuar në nenin 76.7.7.4 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës siç ishte Libreza e punës dhe dëshmitë tjera siç ishin padia kolektive për pagesën e të ardhurave personale të dorëzuara në DHPGJS më 17 mars 2011, vendimin e NSH-së nr. 760/3 datë 03 dhjetor 2003 për dërgimin kolektiv të punëtorëve në pushim pa pagesë, ishin prova të mjaftuara për të konstatuar se paditësi ishte punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Sa i përket pretendimeve të paditurës në ankesën e saj të paraqitur në shkallë të dytë, Kolegji i Apelit vlerëson se e paditura nuk ka paraqitur asnjë argument ligjor apo provë me të cilin do të dëshmonte të kundërtën e asaj që ka provuar paditësi. E paditura ka theksuar se kërkesa e paditësit është parashkruar sepse paditësi nuk ka ndërmarrë ndonjë hap ligjor për të kërkuar kompensimin për ndërprerje të parakohshme brenda afatit tre vjeçar.

Kolegji i Apelit vlerëson se ky pretendim ankimore është i pabazuar pasi që paditësi ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për ndërprerjen e afatit të parashkrimit siç janë: padia kolektive për pagesën e të ardhurave personale të dorëzuara më 17 mars 2011 në Dhomën e Posaçme. Këto prova janë dëshmi të mjaftueshëm me të cilat provohet ndërprerja e parashkrimit të kërkesës së paditësit.

Prandaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, Kolegji i Apelit konsideron se shkalla e parë ka vepruar drejtë kur paditësit i ka njohur të drejtën në dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 750.00 euro dhe në emër të interesit ligjor prej 10% të shumës themelore, i ka njohur shumën prej 75.00 euro, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 20 euro.

Nga arsyet e cekura më lartë, ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimit si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesja e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumë prej 100 euro më 14 qershor 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 17 tetor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
